



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 1635/Prot.

Tiranë, më 24.02.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1357, datë 04.06.2009.

SHOQËRISË “JONI 2008” SH.P.K

Lagjja Nr. 1, Rr. e Korçës, Nr. 154, Pogradec, Korçë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “JONI 2008” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1357, datë 04.06.2009, për mineralin hekur-nikel, në Objektin “Cervenaka Lindore”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1951 Prot., datë 12.02.2026, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 1635, Prot., datë 16.02.2026, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1357, datë 04.06.2009, për mineralin hekur-nikel, në Objektin “Cervenaka Lindore”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2025.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1357, datë 04.06.2009, për mineralin hekur-nikel, në Objektin “Cervenaka Lindore”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", subjekti ka të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1357, datë 04.06.2009, për mineralin hekur-nikel, në Objektin "Cervenaka Lindore", Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

ERLIND SULO

